



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1806/1 prot.

Tiranë, më 13.11.2023

Lënda: Dhënie mendimi mbi projektvendimin

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 16867 prot., datë 07.11.2023, protokolluar me tonën me nr. 1806 prot., datë 09.11.2023, përmes së cilës dërgohet për mendim projektvendimi “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Migracionit 2024-2030 dhe Planit të saj të Veprimit 2024-2026”, më poshtë gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”).

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së Strategjisë dhe dokumenteve shoqëruese vlerësojmë rëndësinë e kësaj iniciative, e cila vjen në harmoni me frymën globale dhe procesin e integritetit të Shqipërisë në BE duke ndërthurur parimet kombëtare dhe ndërkombëtare të politikave migratore.

Duke marrë parasysh rëndësinë e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në procesin e migracionit dhe integritetin e emigrantëve, jemi të mendimit se roli dhe kontributi i institucioneve që monitorojnë këto të drejta është thelbësor.

Për sa më lart, sugjerojmë që Zyra e Komisionerit duhet të jetë pjesë e institucioneve mbështetëse të kësaj Strategjie si institucioni i pavarur që mbikëqyr dhe monitoron të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë.

Mbrojtja e jetës private dhe të dhënave personale është një nga liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, e sanksionuar në nenin 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, së bashku me aktet nënligjore.

Duke qenë se, sipas objektivave dhe masave përkatëse të strategjisë vërejmë se për realizimin dhe funksionimin e gjithë këtij procesi do të ketë përpunim të të dhënave

personale, Zyra e Komisionerit propozon që të jetë pjesë e objektivave specifike në Planin e Veprimit, si më poshtë vijon:

Në *Masën prioritare 1.1.2. Rritja e kapaciteteve institucionale dhe rishikimi i strukturave në institucionet në nivel qendror dhe vendor për qeverisjen efektive të migracionit*, sugjerojmë të shtohet një ndërhyrje me këtë përmbajtje:

“Fushatë ndërgjegjësuese me policë, psikolog, inspektorë të punës, oficerëve të kufirit dhe stafit të autoriteteve kombëtare që mbulojnë çështjet e azilit dhe migracionit me fokus zbatimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale”.

Gjithashtu, në *Masën prioritare 1.2.1 Krijimi i një metodologjie të koordinuar për mbledhjen e të dhënave (sipas planit të statistikave)*, sugjerojmë të shtohet një ndërhyrje me këtë përmbajtje:

“Zhvillimi i trajnimeve për realizimin me përgjegjshmëri të proceseve të përpunimit, shkëmbimit dhe ndërveprimit të të dhënave personale, me qëllim rritjen e aftësive të nëpunësve të ngarkuar me mbledhjen e të dhënave të migracionit.”

Për sa më lart, vlerësojmë se Zyra e Komisionerit (KDIMDP) duhet të parashikohet në Planin e Veprimit si institucion përgjegjës për të zhvilluar këto aktivitete. Gjithashtu, sa i përket kostos së planifikuar të jetë kosto administrative nga buxheti i shtetit.

Me reflektimin e sugjerimeve të mësipërme, Zyra e Komisionerit shprehet dakord me Projektvendimin.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

